



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

DATA/DATE:	26.12.2024
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Shërbime Publike
PËR/ZA/TO:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
CC:	Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti për ecurinë e konsultimit të Draft-Planin Komunal për transport lokal publik 2024-2028

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në Komuna, konkretisht neni 30 për mbledhjen e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Për përgatitjen e Draft-Planit Komunal për transport lokal publik 2024-2028, ka qenë e obliguar Drejtoria për Shërbime Publike, respektivisht udhëheqësi i sektorit Islam Latifi.

Publikimi i njoftimit dhe planit në uebfaqe, platformën e konsultimeve publike, si dhe në rrjetin social facebook të Komunës së Vushtrrisë.

Publikimet:

Më 25.11.2024

Në uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2024/11/Njoftim-per-konsultim-publik-Draft-Plani-i-Transportit-Lokal-Publik-te-Udhetareve-2024-2028-1.pdf>

Draft-Plani:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2024/12/Draft-Plani-i-Transportit-Lokal-Publik-te-Udhetareve-2025-2028.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/KomunaVushtrri/posts/910168171244983>

Në platformën e konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php?OpenPage=0&ClosedPage=0>

Lajmi i cili njofton se kur do të mbahet konsultimi publik i publikuar në uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/news/njoftim-per-konsultim-publik-draft-plani-i-transportit-lokal-publik-te-udhetareve-2024-2028/>

Me datë 09.12.2024, është mbajtur konsultimi publik me qytetarë, ndërsa me 18.12.2024 është publikuar procesverbali nga konsultimi publik:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/category/konsultime-publike/procesverbalet-konsultimeve/>

Draft-Plani Komunal për transport lokal publik 2024-2028, ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe platformën e konsultimeve publike, nga data 25.11.2024 deri më 25.12.2024

Tabela me të dhëna nga konsultimi publik:

Metoda e konsultimit	Data	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa/sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
1-Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë për Draft-Plani Komunal për transport lokal publik 2024-2028	09.12.2024	F M T 0 11 11	3	3

Nr	Kërkesat/Sugjerimet/ Komentet	Kush e ka dhënë kërkesën/ sugjerimin	Statusi i kërkesës/sugjerimit (pranuar, pjesërisht i pranuar apo refuzuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe refuzimin e komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Kërkesë për planifikim të subvencionimit të transportit publik nga komuna	Bashkim Aliu	Pranohet	Në Draftin final do të shtohet edhe çështje.
	2. Kërkesë për rregullim të vend ndaljeve për autobusë në të gjitha vend ndaljet.	Esat Ibishi	Pranohet,	Pranohet, sepse edhe ashtu është pjesë e aktiviteteve të planit
	3. Te eliminohet transporti ilegal, me kombibusa etj.	Ruzhdi Fetahu	Pranohet	Në Draftin final një prej aktiviteteve do të jetë angazhimi i inspeksionit në ndalimin e transportit ilegal.

Shkurtesat: F-Femra, M-Meshkuj, T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Raporti është përgatitur nga:

Islam Latifi – sektori për infrastrukturë rrugore.





Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria për Shërbime Publike

Datë/a 25.11.2024

Në mbështetje të të nenit 12, paragrafi 2 pika „d” të Ligjit nr. 03L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovë, nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komunë, Komuna e Vushtrrisë organizon:

KONSULTIM PUBLIK
PËR DRAFT – PLANIN E TRANSPORTIT LOKAL PUBLIK TË UDHËTARËVE 2024-2028

Drejtoria për Shërbime Publike e ka vënë për konsultim publik Draft-Planin e Transportit Lokal Publik të Udhëtarëve 2024-2028.

Konsultimi publik do të zgjasë nga data 25.11.2024 deri më 25.12.2024.

Prandaj njoftojmë qytetarët, operatorët e transportit, OJQ-të, shoqërinë civile dhe të gjithë të interesuarit, se me datën 09.12.2024 e (hënë) do të organizojmë konsultim publik në sallën e Kuvendit, në objektin e Komunës së Vushtrrisë me fillim nga ora 10:00.

Ju inkurajojmë që të merrni pjesë në takimin dhe mirëpresim propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet eventuale gjatë këtij konsultimi publik.

Po ashtu ju njoftojmë se propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet e juaja mund ti dërgoni në adresën elektronike islam.latifi@rks-gov.net.

Për gjithë kontributin tuaj paraprakisht ju falënderojmë.



Drejtori i drejtorisë

Benjamin Shala
Benjamin Shala